



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni IV

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 06 .

Prishtinë, më 9.03.2015, në ora 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Agim Çeku, Mufera Sinik, Agim Kikaj, Blerim Shala, Çerim Bajrami, Veton Berisha dhe Danush Ademi .

Munguan: Saša Milosavljević, Fisnik Ismaili, Milka Vuletić, Slavko Simić dhe Jasmina Živković.

Nga pjesëmarrësit e tjerë: përfaqësues nga OSBE-ja Ardiana Gashi, përfaqësues të TV- Rokum-Dugagjin Maliqi, përfaqësues të RTK-21 Liridona Xhemajli, përfaqësues të Ambasadës Zvicerane Sakibe Jashari, përfaqësues i Sekretariatit të KKK - Zijush Ahmeti dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit – Celal Iliaz.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit, Koordinatorë - Natasa Prica-Tishma, Zyrtare e lartë ligjore- Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Agim Çeku, zëvendëskryetar i parë i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve të mbajtura më 19, 22 dhe 29.01.2015;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-02 për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit me rekomandime të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së;**
- 4. Të ndryshme.**

- 1. Miratimi i rendit të ditës**

Agim Çeku– konstatoi se rendi i ditës u miratua, pa ndryshime.

- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve të mbajtura më 19, 22 dhe 29.01.2015;**

Kryesuesja - konstatoi se komisioni miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 19,22 dhe 29.01.2015, pa vërejte.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-02 për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit me rekomandime të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së;

Zëvendëskryesuesi – paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.05/L-02 për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit së bashku me rekomandimin e Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së;

Fillimisht ai tha se Komisioni funksional ka shqyrtuar projektligjin në tërësi dhe nuk ka paraqit amendamente dhe ka vendosur që i njëjti të procedohet nëpër lexim të dytë, në Kuvend.

Zëvendëskryesuesi – i njoftoi anëtarët e komisionit se lidhur me shqyrtim të këtij projektligji kemi edhe një propozim amendament të GP – Nisma - nga deputeti Zarif Berisha dhe shtoi se komisioni funksional ka dalë me rekomandim se të njëjtin nuk e përkrah.

Ai hapi depat, me qëllim që anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim lidhur me amendamentin e deputetit Zarif Berisha.

Cerim Bajrami –si anëtarë edhe në komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së, tha se komisioni ka shqyrtuar propozim amendamentin e GP -Nisma nga deputeti Zarif Berisha dhe ka vlerësuar se ky propozim ndryshon esencën e projektligjit. Andaj, Komisioni funksional ka dalë me rekomandim se i njëjti nuk është përkrahur. Ai shtoi se komisioni ka vendos që propozimi i GP – Nisma, të shkojë si propozim i dytë në Kuvend.

Sipas mendimit të tij, si çështja esenciale për komisionin tanë është se, përmbajtja e projektligjit bazik nuk paraqet shkelje të të drejtave të komuniteteve.

Pas diskutimeve, zëvendëskryesuesi, konstatoi se Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri nxorri këtë:

Rekomandim

- I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr.05/L-02 për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Raporti i propozuar nga komisioni Funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së në Projektligjin nr.05/L-02 për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.
- III. Komisioni ka shqyrtuar edhe propozim amendamentin e Grupit Parlamentar Nisma- nga deputeti Zarif Berisha, të cilën nuk e përkrahu.

4. Të Ndryshme

Veton Berisha, ai ngriti dy çështje, së pari kërkoi sqarim nga zot. Shala, i cili është anëtar i delegacionit për marrëveshjen Prishtinë - Beograd, lidhur me atë se a është shqyrtuar drejtë vendimi për përzgjedhjen e gjyqëtarëve dhe prokurorëve vetëm të komunitetit shqiptar dhe atij serb, deri sa për zgjedhjen e këtij procesi është pamundësuar për komunitetet tjera jo shqiptare dhe jo serbe.

Jemi në dijeni se lista serbe bojkoton punën në Kuvend, në momentin kur ata marrin vendim për tu kthyer është në interes të të gjithëve pasi përbëjnë një numër të konsiderueshëm të ulësve në Kuvend. Lidhur me këtë problematikë nuk do të thotë të pezullohet puna e komisionit.

Në kuadër të përgjegjësive të saja, si komision i përhershëm duhet ti trajtoj njëjtë çështjet e komuniteteve të cilët jetojnë dhe veprojnë në Kosovë. Për deri sa ka kvorum, komisioni mund të shqyrtojë dhe procedojë çështjet të cilat kërkojnë ndërhyrje të shpejtë, për nga aspekti i të drejtave dhe interesave të komuniteteve.

Në kuadër të Planit të Punës, komisioni mund të dal ne teren për të vëzhguar si zhvillohet jetesa e komunitetit pakicë.

Në bazë të diskutimeve, zëvendëskryesuesi konstatoi se Komisioni, njëzëri nxorri këtë:

Përfundim

Në mbledhje të Komisionit, të ftohet ministri i Drejtësisë zot, Hajredin Kuqi, që të raportoj për sistemin e gjyqësisë lidhur me strukturën e emërimit të gjyqëtarëve dhe prokurorëve, në bazë të marrëveshjes Prishtinë- Beograd.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Zëvendëskryetar i parë i Komisionit

Agim Çeku